



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
USTAVNI SUD  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 8 gusht 2024  
Nr. ref.: RK 2503/24

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**rastin nr. KI38/24**

Parashtrues

**Rexhep Vrapca**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Rev. nr. 38/23] të 6 shtatorit 2023  
të Gjykatës Supreme**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi, gjyqtar

#### Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është dorëzuar nga Rexhep Vrapca nga Prishtina (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Salih Gjonbalaj, avokat në Prishtinë.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 38/2023] të 6 shtatorit 2023 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme).
3. Parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme e kishte pranuar më 19 tetor 2023.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 16 shkurt 2024, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
7. Më 21 shkurt 2024, Kryetarja e Gjykatës përmes vendimit [nr. GJR. KI38/24] caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe përmes vendimit [nr. KSH. KI38/24] Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Remzie Istrefi-Peci (kryesuese), Nexhmi Rexhepi dhe Enver Peci, anëtarë.
8. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
9. Më 19 mars 2024, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës, dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
10. Më 16 korrik 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

11. Bazuar në shkresat e lëndës, parashtruesi i kërkesës dhe paditësit që në këtë rast janë vëllezër, objekt kontesti kanë pronën në sipërfaqe prej 656m<sup>2</sup> vendi i quajtur "Varosh" në zonën kadastrale Lipjan, të cilën e kishin blerë paditësit Valdet Vrapca dhe Misret Vrapca nga J. D., mirëpo kontrata e shitblerjes me pajtimin e paditësve ishte bërë në

mes të parashtruesit të kërkesës si blerës dhe J. D. si shitës. Padi tësit kishin shprehur interesimin që të ndërtojnë në këtë ngastër dhe kur kishin kontaktuar parashtruesin e kërkesës, ai ua kishte mohuar të drejtën që të kenë mundësi të ndërtojnë në të apo të ndërmarrin cilindo veprim në këtë ngastër me arsyetimin se ngastra është e tij dhe se është vetëm e tij pasi edhe evidentohet në emër të tij.

12. Më 26 gusht 2015, paditësit Valdet Vrapca dhe Misret Vrapca, njëherit vëllezërit e parashtruesit të kërkesës, parashtruan padi për vërtetimin e pronësisë në Gjykatën Themelore në Prishtinë–dega në Lipjan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) kundër parashtruesit të kërkesës, ku nga gjykata kërkuan që të aprovet padia e tyre si e bazuar dhe të vërtetohet se janë bashkëpronar në pjesë të barabarta prej nga 1/2 të ngastrës kadastrale vendi i quajtur “Varosh” në sipërfaqe prej 656m<sup>2</sup> e evidentuar në certifikatën e pronës 3977 ZK. Lipjan, si dhe të detyrohet i padituri, në këtë rast parashtruesi i kërkesës, që paditësve t’ua pranoj këtë të drejtë. Padi tësit gjithashtu kishin propozuar që gjykata të caktojë masën e përkohshme të sigurimit ashtu që parashtruesit të kërkesës t’i ndalohet të bëjë bartjen, transferojë, ngarkojë me ndonjë të drejtë sendore ose ndryshimin e gjendjes ekzistuese të paluajtshmërisë në kontest.
13. Më 27 gusht 2015, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [C. nr. 301/2015] vendosi: I. Caktoi masën e përkohshme të sigurimit të kërkesëpadiës me të cilën kundërshtarit të sigurimit Rexhep Vrapca nga fshati Gadime e Epërme, i ndalohet që të bëjë bartjen, transferojë, ngarkojë me ndonjë të drejtë tjetër sendore ose ndryshoj gjendjen e paluajtshmërisë në përbërje prej ngastrës kadastrale P-71409044-01964-2 në vendin e quajtur Varosh në sipërfaqe prej 656m<sup>2</sup> në ZK. Lipjan; II. kjo masë e përkohshme e sigurimit mbetet në fuqi, përderisa gjykata të mos merr vendim tjetër mbi masën e sigurimit apo derisa vendimi i kësaj gjykate, mbi çështjen kryesore juridiko-civile, të bëhet i formës së prerë; III. obligoi propozuesit e sigurimit që në mënyrë solidare kësaj gjykate t’ia paguajnë shumën prej 20,00.€ brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktvendimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.
14. Më 23 gusht 2017, Gjykata Themelore përmes aktvendimit [C. nr. 301/15] detyroi parashtruesin e kërkesës që të paraqesë përgjigje në padi dhe të deklarohet se a e pranon apo e konteston kërkesëpadinë e paditësve.
15. Më 6 shtator 2017, parashtruesi i kërkesës parashtroi përgjigje në padi, ku ndër të tjera theksoi: *“Nga të gjitha faktet dhe provat e paraqitura, të gjitha pretendimet e paditësve janë të pabazuara, me arsyetim se paditësit nuk kanë lidhur kurrfarë kontrate gojore, por as të formës së shkruar për shitblerjen e paluajtshmërisë kontestuese me shitësin, sepse sikur të kishin lidhur këtë kontratë në format e cekura, atëherë nuk do të kishin dhënë pëlqimin që i padituri të lidhë kontratë me shitësin dhe aktin e regjistrimit të kësaj paluajtshmërie në regjistra të paluajtshmërive në pronësi individuale të paditurit Rexhep Vrapca do ta kishin kontestuar me ndonjë padi pronësore, mirëpo kundërshtime të tilla brenda afateve ligjore nuk kanë bërë, andaj në pajtim me dispozitat e nenit 40 al.2 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, kërkesëpadia e paditësve në drejtim të paluajtshmërisë kontestuese është parashkruar dhe si e tillë duhet të refuzohet si e pabazuar”*.
16. Më 24 janar 2019, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 301/2015] vendosi si në vijim: I. Aprovoi kërkesëpadinë e paditësve Valdet Ismajl Vrapca dhe Misret Ismajl Vrapca, që të dy nga fshati Gadime e Epërme, si e bazuar dhe vërtetohet se paditësit, mbi bazën e kontributit familjar të përbashkët e kanë fituar të drejtën e bashkëpronësisë secili paditës nga 1/3 e pjesës së paluajtshmërisë në përbërje prej ngastrës kadastrale P- 71409044-01964-2, në vendin e quajtur "Varosh", e cila është në sipërfaqe të përgjithshme prej 656m<sup>2</sup> ZK Lipjan, dhe obligoi të paditurin Rexhep

Ismajl Vrapca nga fshati Gadime Epërme, që të dhurojnë që nga 1/3 pjesës së paligjshmërisë të regjistruar në regjistra të paluajtshmërive në bashkëpronësi të paditësve, në të kundërtën ky aktgjykim do t'u shërbej si dokument juridik për regjistrimin e kësaj të drejte pronësore në regjistra të paluajtshmërive në bashkëpronësi të paditësve; II. Obligoi të paditurin që paditësve t'ua kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 1.606,24 euro, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

17. Më 10 korrik 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimi i ankimor të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësve të refuzohet si e pabazuar ose aktgjykimi të prishet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.
18. Më 14 nëntor 2022, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [CA. nr. 2271/2019] refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Themelore e vërtetoi. Gjykata e Apelit, ndër të tjera, arsyetoi: *"I padituri, deri në përfundimin e çështjes në gjykatën e shkallës së parë, e as në procedurë sipas ankesës nuk provoi, në masën e duhur me fakte dhe prova relevante se këtë patundshmëri e ka blerë vetëm me kontributin e tij, edhe përkundër faktit se e kishte barrën e provës. Pretendimi ankimor i të paditurit, se është pronar i vetëm i patundshmërisë objekt kontesti, e cila ishte blerë gjatë ekzistimit të bashkësisë familjare, me paditësit, si në rastin konkret, nuk mund të provohet vetëm me faktin se patundshmëria është regjistruar në emrin e tij, në regjistrin përkatës kadastral, për regjistrimin e të drejtave pronësore në patundshmëri, por i padituri në këtë rast duhej të provonte faktin vendimtar se patundshmërinë objekt kontesti e ka blerë vetëm me kontributin e tij personal, respektivisht se paditësit nuk kanë kontribut në blerjen e kësaj patundshmërie"*.
19. Më 31 dhjetor 2022, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që aktgjykimi ankimor të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësve të refuzohet si e pabazuar ose aktgjykimi të prishet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.
20. Më 19 janar 2023, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [C. nr. 301/2015] hoqi nga fuqia masën e përkohshme të sigurimit të kërkesëpadisë, e caktuar me aktvendimin e kësaj gjykate [C. nr. 301/2015] të 27 gushtit 2015.
21. Më 6 shtator 2023, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 38/2023] refuzoi si të pathemeltë revizionin e parashtruesit të kërkesës.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

22. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 38/2023] e 6 shtatorit 2023 të Gjykatës Supreme, me pretendimin se i njëjti është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 54 [ Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

*Pretendimet lidhur me shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]*

23. Parashtruesi i kërkesës fillimisht pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, duke aluduar në mosarsyetimin e vendimit nga ana e Gjykatës Supreme, ku siç thekson ai “*Përveç kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e arsyetimit të aktgjyqimit ka bërë shkelje të parimit të arsyetimit për faktin se ka shpërfillur dhe injoruar në tërësi pretendimet e palës së paditur të dhëna në revizionin. Aktgjyqimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, me tepër i ngjason në një aktgjykim të Gjykatës së Apelit si gjykatë e faktit sesa me atë të një gjykate që është garant për mbrojtje të ligjshmërisë së vendimeve gjyqësore*”.
24. Tutje parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme është bazuar në Ligjin për Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare nr./10/28 të vitit 1984, ndërsa nuk ka marrur për bazë kontratën e shitblerjes, ku ndër të tjera thekson: “*Në arsyetim të aktgjyqimit shihet se i gjithë fokusi ka qenë në interpretim të nenit 326 dhe 328 të Ligjit të Për martesën dhe marrëdhëniet familjare nr./10/28, mars 1984. Ndërsa as gjykata e shkallës së parë as gjykata e shkallës së dytë po as Gjykata Supreme nuk mori për bazë kontratën e shitblerjes e cila është lidhur me datën 09.08.2002 e cila është vërtetuar në gjykatën komunale në Lipjan e që nga ajo kohë e deri në vitin 2015 asnjëherë paditësit nuk kanë pasur pretendime lidhur me atë pronë dhe lidhur me pretendimet e paditësve ka ardhur pas vdekjes së babait të tyre Ismail Vrapci e që lidhet shumë qartë se sa ka qenë gjallë babai i tyre nuk ka pasur pretendime nga paditësit për faktin se sipas pëlqimit të të gjithëve dhe të babait të tyre kontrata e shitblerjes të kësaj ngastre që ka qenë objekt i shqyrtimit të jetë në emër të të paditurit Rexhep Vrapci dhe pronë e tij*”.
25. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 54 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës, në esencë, thekson: “*Marr parasysht të gjitha të cekurat më lart me vendime të ndryshme të gjykatave të zakonshme për rastet të njëjta gjykatat nuk kanë vepruar drejt në raport me z. Rexhep Vrapca për mbrojtje gjyqësore për t’i realizuar të drejtat e tij në pronën e tij, përkatësisht për të drejtën të fituar në kohën kur paditësit dhe i padituri kanë qenë në bashkësi familjare dhe me pëlqimin e të gjithëve e duke përfshirë edhe babin e tij Ismajl Vrapci, janë dakorduar që prona të kalon në pronësi të Rexhep Vrapcit, dhe kjo çështje është theksuar në padinë edhe të vetë paditësve që prona të kalojë në emër të Rexhep Vrapcit*”.
26. Në fund, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon: (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; dhe (ii) të konstatojë se Aktgjykimin [Rev. nr. 38/2023] të 6 shtatorit 2023 i Gjykatës Supreme nuk është në përputhshmëri me nenet e Kushtetutës, dhe të njëjtin ta shpallë të pavlefshëm dhe çështjen ta kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje.

## **Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

#### **Neni 31**

#### **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

*“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*

*2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.*

*[...]*

**Neni 54**  
**[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]**

*Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.*

**Neni 102**  
**[Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]**

- 1. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovë ushtrohet nga gjykatat.*
- 2. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.*
- 3. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.*
- 4. Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.*
- 5. Garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. E drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, rregullohet me ligj. Me ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe për të tilla raste nuk ka të drejtë ankese.*

**Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

**NENI 6**  
**E drejta për një proces të rregullt**

*1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.*

**Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

27. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113  
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.  
[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*  
[...]

29. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.  
2. Individë mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

Neni 49

[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ...”.*

30. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës: është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ai e konteston kushtetutshmërinë e një akti të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 38/2023] e 6 shtatorit 2023 të Gjykatës Supreme; se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; se i ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit.
31. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht nënrrregullin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës, që përcakton:

*(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj.*

32. Gjykata rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpall një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 34 të Rregullores së punës (shih rastin



[Kl04/21](#), parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 majit 2021, paragrafi 26; shih gjithashtu rastin [Kl175/20](#), parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 prillit 2021, paragrafi 37).

33. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “*qartazi e pabazuar*” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNJ-së (shih, rastin e GjEDNJ-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës [Kl166/20](#), parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuzë dhe të paqarta*” (shih, rastet e GjEDNJ-së, [Kemmache kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), [Juta Mentzen kundër Lituaniës](#), nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii).
34. Në këtë kontekst, si dhe në vazhdim të tekstit, vlerësimi nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin [Kl04/21](#), cituar më lart, paragrafi 28).
35. Rrethanat e rastit konkret, rezultojnë nga një kontest pronësor ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe vëllezërve të tij. Vëllezërit e parashtruesit të kërkesës kishin parashtruar padi së bashku me kërkesën për masë të përkohshme të sigurimit në Gjykatën Themelore kundër parashtruesit të kërkesës, me objekt kontesti vërtetimin e pronësisë lidhur me pronën P- 71409044-01964-2, në vendin e quajtur "Varosh", e cila është në sipërfaqe të përgjithshme prej 656m<sup>2</sup> ZK Lipjan, të cilët pretendonin se këtë pronë e kishin blerë dhe në të cilën në momentin që kishin dashur të investonin nuk ishin lejuar nga parashtruesi i kërkesës. Gjykata Themelore kishte vendosur masën e përkohshme të sigurisë lidhur me pronën në fjalë. Gjithashtu, Gjykata Themelore kishte aprovuar kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar dhe kishte vendosur që në bazë të kontributit familjar të përbashkët paditësit e kanë fituar të drejtën e bashkëpronësisë secili paditës nga 1/3 të pjesës së paluajtshmërisë, dhe të regjistrohesh në regjistra të paluajtshmërive në bashkëpronësi të paditësve. Parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjyqimit të Gjykatës



Themelore, mirëpo Gjykata e Apelit e kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e tij dhe e kishte vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur revizion në Gjykatën Supreme, ku kjo e fundit e kishte refuzuar si të pathemeltë revizionin e paraqitur. Gjithashtu edhe Gjykata Themelore kishte shfuqizuar masën e përkohshme të sigurimit të caktuar me aktvendim nga ana e kësaj gjykate.

36. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 54 [ Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
37. Gjykata vëren se esenca e pretendimeve për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, ndërlidhet me mosarsyetimin e vendimit gjyqësor nga ana e Gjykatës Supreme. Gjykata vlerëson se pretendimet e tilla ngrenë çështje nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6.1 i KEDNJ-së, të cilat Gjykata do t'i analizojë në pajtueshmëri me standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.
38. Gjykata fillimisht do trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljet e nenit 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së, lidhur me mosarsyetimin e vendimit nga Gjykata Supreme, duke vazhduar më pas me pretendimin lidhur me shkeljen e nenit 54 dhe 102 të Kushtetutës.

### **Pretendimet lidhur me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së**

*(i) Sa i përket pretendimit për vendim të paarsyetuar gjyqësor*

39. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij pranë Gjykatës, në esencë, pretendon se Gjykata Supreme nuk ka arsyetuar se cilat kanë qenë faktet dhe provat të cilat kanë ndikuar në marrjen e vendimit, pasi që “... përveç kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e arsyetimit të aktgjykimin ka bërë shkelje të parimit të arsyetimit për faktin se ka shpërfillur dhe injoruar në tërësi pretendimet e palës së paditur të dhëna në revizionin. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës më tepër i ngjason në një aktgjykim të Gjykatës së Apelit si gjykatë e faktit se sa me atë të një gjykate që është garant për mbrojtje të ligjshmërisë së vendimeve gjyqësore”.
40. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (përfshirë, por duke mos u kufizuar në rastet [Hadjianastassiou kundër Greqisë nr.12945/87](#), Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; [Van de Hurk kundër Holandës](#), Aktgjykim i 19 prillit 1994; [Hiro Balani kundër Spanjës nr.18064/91](#), Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; [Higgins dhe të tjerët kundër Francës nr.134/1996/753/952](#), Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; [Garcia Ruiz kundër Spanjës nr.30544/96](#), Aktgjykimi i 21 janarit 1999; [Hirvisaari kundër Finlandës nr.49684/99](#), Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; [Suominen kundër Finlandës nr.37801/97](#), Aktgjykim i 1 korrikut 2003; dhe [Tatishvili kundër Rusisë nr.1509/02](#), Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007.) Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate (duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në [KI22/16](#), parashtrues Naser Husaj,



Aktgjykim i 9 qershorit 2017; [KI97/16](#), parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 9 janarit 2018; [KI143/16](#), parashtrues *Muharrem Blaku* dhe të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018; [KI87/18](#), parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019; si dhe rastin [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135).

41. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastin e Gjykatës [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, të cituar më lart, paragrafi 139 dhe rastin [KI87/18](#), parashtrues *IF Skadiforsikring*, paragrafi 44).
42. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih në mënyrë të ngjashme rastet e GJEDNJ-së [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe [Higgins dhe të tjerët kundër Francës](#), paragrafi 42; shih, po ashtu, rastin e Gjykatës [KI97/16](#), parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin [KI87/18 IF Skadeforsikring](#), të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin [Moreira Ferreira kundër Portugalisë nr.19867/12](#), Aktgjykim i 5 korrikut 2011, paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastin e Gjykatës [KI195/20](#), parashtrues *Aigars Kesengfelds, pronar i institucionit financiar jo-bankar "Monego"*, Aktgjykim i 29 marsit 2021, paragrafi 122).
43. Gjykata me këtë rast rikujton se të tri shkallët e gjykatave të rregullta kishin vendosur në favor të paditësve, dhe njëherit kishin obliguar parashtruesin e kërkesës që nga 1/3 e pjesës së paluajtshmërisë të regjistrohet në regjistra të paluajtshmërive në bashkëpronësi të paditësve, në këtë rast vëllezërve të parashtruesit të kërkesës.
44. Gjykata vëren se Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 301/2015] të 24 janarit 2019, aprovoi kërkesëpadinë e paditësve dhe kishte vendosur që në bazë të kontributit familjar të përbashkët paditësit e kanë fituar të drejtën e bashkëpronësisë secili paditës nga 1/3 të pjesës së paluajtshmërisë, dhe paluajtshmëria të regjistrohet në regjistra të paluajtshmërive në bashkëpronësi të paditësve. Gjykata Themelore ndër të tjera kishte theksuar si në vijim:

*“Nga këto prova të administruara, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike se paditësit me te paditurin janë vëllezër, se babain e tyre, në kohën sa kanë jetuar në bashkësi të përbashkët familjare dhe ekonomike, në vitin 2002, me pasurinë e përbashkët të krijuar në bashkësi familjare e kanë blerë paligjshmërinë kontestuese nga shitësi Jovanović Dragan nga Lipjani, për çmimin e shitblerjes prej 147.000,00€, i cili çmim i shitblerjes i është paguar në tërësi shitësit me para në dorë, dhe në emër të bashkësisë familjare kontratën në emër të blerësit e ka nënshkruar i padituri, i cili me këtë kontratë për shitblerjen e paluajtshmërisë, nënshkrimet e së cilës janë vërtetuar në Gjykatën Komunale në Lipjan me shenjë*

Vr.nr.1686/2002 të dt.09.08.2002,e ka bartur pronësinë në regjistrat ku mbahet evidenca e paluajtshmërive në pronësi në ZKK në Lipjan në emër të vet, si bashkësi familjare kanë hyrë në posedim në paligjshmërinë kontestuese, ende nuk e kanë ndarë pasurinë e përbashkët të fituar në bashkësinë familjare me kontributin e tyre të përbashkët. [...]

Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi nga dëgjimi i paditësit Misret Vrapca në cilësi të palës, dëshmisë së dëshmitares Ibadete Haliti i vajzërisë Vrapca nga Tetova, motra e palëve ndërgjyqësore, dëshmisë së dëshmitarit Ajvaz Ukshini nga fshati Gadime Epërme, si dhe pjesërisht edhe nga deklaratat e të paditurit të dhënë në cilësi të palës, ku përveç tjerash deklaroi se kjo tokë është blerë me parat e bashkësisë familjare, dëshmi këto të cilat ishin bindëse dhe e plotësonin njëra-tjetrën, e të cilave gjykata në tërësi ua fali besimin. Me dispozitën e nenit 326 të Ligjit për martesën dhe Marrëdhëniet Familjare (Gazeta Zyrtare e KSAK-së nr. 10) parashihet se kur në bashkësinë familjare me bashkëshortët përkatësisht me bashkëshortët jashtëmartesor, fëmijët e tyre dhe personat e tjerë në gjini, të cilët punojnë në pasurinë bujqësore ose bashkërisht ushtrojnë veprimtari të tjera, ose ndonjë mënyrë tjetër punojnë bashkërisht, pasuria e fituar gjatë vazhdimit të asaj bashkësie është pasuri e përbashkët e të gjithë anëtarëve të bashkësisë familjare, të cilët marrin pjesë në fitimin e saj”.

45. Më tej, Gjykata e Apelit duke refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës përmes Aktgjykimit [CA. nr. 2271/2019] të 14 nëntorit 2022, ndër të tjera theksoi:

“...I padituri, deri në përfundimin e çështjes në gjykatën e shkallës së parë, e as në procedurë sipas ankesës nuk provoi, në masën e duhur me fakte dhe prova relevante se këtë patundshmëri e ka blerë vetëm me kontributin e tij, edhe përkundër faktit se e kishte barrën e provës. Pretendimi ankimor i të paditurit, se është pronar i vetëm i patundshmërisë objekt kontesti, e cila ishte blerë gjatë ekzistimit të bashkësisë familjare, me paditësit, si në rastin konkret, nuk mund të provohet vetëm me faktin se patundshmëria është regjistruar në emrin e tij, në regjistrin përkatës kadastral, për regjistrimin e të drejtave pronësore në patundshmëri, por i padituri në këtë rast duhej të provonte faktin vendimtar se patundshmërinë objekt kontesti e ka blerë vetëm me kontributin e tij personal, respektivisht se paditësit nuk kanë kontribut në blerjen e kësaj patundshmërie”.

46. Gjithashtu edhe Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 38/2023] refuzoi si të pathemeltë revizionin e parashtruesit të kërkesës, ku ndër të tjera arsyetoi:

“Gjykata Supreme vlerëson se në këtë rast mbi bazën e gjendjes faktike të konstatuar nga gjykata e shkallës së parë e që është pranuar edhe nga gjykata e shkallës së dytë rezulton se nga gjykatat e instancës më të ulët e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë nga ka rezultuar se kërkesëpadia është e bazuar, në përputhje me nenin 326 dhe 328 të Ligjit për Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare Nr. 10/28, mars 1984. Kjo gjykatë ka vlerësuar të pabazuar pretendimin e të autorizuarit të paditësit për çështjen e bazës mbi të cilën i padituri është regjistruar pronar i paluajtshmërisë kontestuese, pasi që në këtë rast nuk shtrohet çështja e bazës ligjore mbi të cilën i padituri është bërë pronar i paluajtshmërisë kontestuese, ngase është e qartë se i padituri në kohën sa ka jetuar në familje të përbashkët me paditësit ka blerë këtë paluajtshmëri dhe vetëm formalisht është regjistruar si pronar. Këtu është shtruar çështja e të drejtës së paditësve në këtë paluajtshmëri, marrë për bazë kohën kur është blerë ajo dhe kontributin e tyre në blerjen e të njëjtës. Nga provat e administruara në këtë proces gjyqësor është vërtetuar fakti se paluajtshmëria është blerë në vitin 2002 dhe se në kohën kur është blerë, paditësit, i padituri dhe anëtarët e tjerë të

*familjes kanë jetuar në një bashkësi familjare dhe se të hollat për blerjen e kësaj paluajtshmërie janë siguruar nga paditësit (të hollat e dërguara nga puna në Gjermani) si dhe kontributi i të paditurit, i cili në atë kohë ka punuar si veterinar dhe kontributin e përbashkët të anëtarëve të familjes. Ndërsa vet i padituri i dëgjuar në cilësi të palës, në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor të datës 05.09.2018 ka deklaruar se toka në Lipjan është blerë me paret e bashkësisë familjare”.*

47. Gjykata fillimisht vëren se Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit e më pas edhe Gjykata Supreme, duke u mbështetur në nenin 326 dhe 328 të Ligjit për Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare Nr. 10/28, mars 1984, në esencë theksuan se parashtruesi i kërkesës nuk ka vepruar ashtu siç parashihet në dispozitat e lartcekura. Në këtë aspekt, Gjykata Supreme, konstatoi se kjo paluajtshmëri ishte fituar në kohën kur parashtruesi i kërkesës dhe vëllezërit e tij ishin në bashkësi familjare dhe kjo konsiderohet si pasuri e përbashkët e tyre e blerë sa kanë qenë duke jetuar së bashku dhe mbi bazën e kontributit familjar të përbashkët të gjithë anëtarëve të familjes të cilët në forma të ndryshme kanë marrë pjesë në krijimin e saj, dhe që rezulton që paditësit, në këtë rast vëllezërit e parashtruesit të kërkesës, janë bashkëpronarë me nga 1/3 e pjesës së paluajtshmërisë kontestuese.
48. Gjykata me këtë rast, rikujton se nisur nga praktika e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës, e njëjta nuk kërkon përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës. Megjithatë, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar.
49. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në revizion drejtuar Gjykatës Supreme, kishte theksuar se gjykatat nuk kanë vërtetuar se kemi të bëjmë me bashkëndërgjyqësi të domosdoshme. Të njëjtit pretendim të parashtruesit, Gjykata Supreme i ishte përgjigjur në aktgjykimin e saj, ku kishte theksuar se *“Nuk është pranuar pretendimi i të autorizuarit të paditurit në lidhje me çështjen e bashkëndërgjyqësisë së domosdoshme, ngase në këtë rast kemi të bëjmë me palë paditëse dhe në raport me palën paditëse nuk vlen instituti i bashkëndërgjyqësisë së domosdoshme. Bashkëndërgjyqësia e domosdoshme vlen në raport me palën e paditur dhe në këtë rast pala e paditur është ajo që ka regjistruar paluajtshmërinë në emrin e tij, ndërsa secili nga personat që pretendon se ka të drejtë në këtë paluajtshmëri apo ka kontribuar në krijimin e saj ka pasur mundësinë që të paraqitet palë në këtë procedurë”.*
50. Në këtë kontekst, Gjykata, duke u bazuar në sqarimet si më sipër, dhe në mënyrë specifike duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, dhe gjithashtu arsyetimet e gjykatave të rregullta e të shtjelluara më lart, konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk karakterizohet me mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor. Për pasojë, pretendimi i parashtruesit të kërkesës përkitazi me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor është qartazi i pabazuar në bazë kushtetuese në *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”* ashtu siç përcaktohet me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.

### ***Përkitazi me pretendimet për shkeljen e nenit 54 dhe 102 të Kushtetutës***

51. Sa i përket pretendimeve për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 54 dhe 102 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se sipas praktikës gjyqësore të vendosur mirë të GJEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me kriterin (iii) pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”* kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht:



- a) kur parashtruesi/ja thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih, në këtë drejtim, rastin e GJEDNJ-së [Trofimchuk kundër Ukrainës \(Vendim\)](#) nr. 4241/03, i 31 majit 2005, shih, gjithashtu, rastin [Baillard kundër Francës \(Vendim\)](#) nr. 6032/04, i 25 shtatorit 2008);
- b) kur parashtruesi/ja nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij/saj (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij/saj dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, nëse autoritetet e burgut refuzojnë të paraqesin në Gjykatë dokumentet nga shkresat e lëndës së të burgosurit për të cilin bëhet fjalë) ose nëse vetë Gjykata nuk vendos ndryshe.
52. Siç u cek më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, shkel të drejtat e tij të garantuara me nenin 54 dhe 102 të Kushtetutës. Mirëpo, parashtruesi i kërkesës vetëm i përmend nenet përkatëse, por nuk shtjellon më tutje se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e këtyre neneve përkatëse të Kushtetutës. Për më tepër, Gjykata vë në pah se pretendimi për shkelje të nenit 102 mund të ngritet në mënyrë të argumentuar nga parashtruesit individual, vetëm në ndërlidhje me ndonjë të drejtë specifike të garantuar nga Kapitulli II dhe III të Kushtetutës. Prandaj, ky nenë në mënyrë të pavarur nuk mund të zbatohet nëse faktet e çështjes nuk bien në fushën e veprimit të paktën të njërës ose më shumë dispozitave të Kushtetutës që kanë të bëjnë me *“gëzimin e të drejtave dhe lirive të njeriut”*. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesave duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës Kushtetuese [KI187/18 dhe KI11/19](#), parashtrues: *Muhamet Idrizi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 korrikut 2019, paragrafi 73; [KI125/19](#) parashtrues: *Ismaj Bajgora*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020, paragrafi 63; dhe së fundmi rastin [KI175/20](#), parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 26 marsit 2021, paragrafët 79-82).
53. Thënë këtë, Gjykata konsideron se pretendimin për shkelje të neneve përkatëse të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës, në të vërtetë, i ka elaboruar mbi bazën e nenit 31 të Kushtetutës, duke e ndërlidhur shkeljen e këtyre të drejtave themelore, me mos arsyetimin e vendimeve gjyqësore, për çfarë Gjykata sa më sipër konstatoi se në këtë pjesë kërkesa duhet të shpallet qartazi e pabazuar, në baza kushtetuese dhe rrjedhimisht e papranueshme, për arsyet e lartcekura.
54. Prandaj, Gjykata konstaton se përkitazi me këto pretendime të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 54 dhe 102 të Kushtetutës, Gjykata konkludon që kjo pjesë e kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i përkasin kategorisë së (iii) pretendimeve *“të pambështetura ose të paarsyetuara”*, sepse parashtruesi i kërkesës thjesht citoi nenet e Kushtetutës, pa shpjeguar se si janë shkelur ato. Rrjedhimisht, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.



## Përfundim

55. Si përmbledhje, Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me mos arsyetimin e vendimit gjyqësor, që bien në fushëveprimin e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6.1 të KEDNJ-së, i përkasin kategorisë së dytë (ii) të pretendimeve “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”, andaj të njëjtat duhet të deklarohen qartazi të pabazuara, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.
56. Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 54 dhe 102 të Kushtetutës, duhet të deklarohen të papranueshme si qartazi të pabazuara pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i përkasin kategorisë së (iii) pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”.
57. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj, duhet të deklarohet e papranueshme.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 16 korrik 2024, njëzëri

## VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Radomir Laban

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani